

EVALDA PACI

**LEXIMI I VEPRAVE TË MARIN BARLETIT,
MES INTERPRETIMESH DHE RIMARRJESH
SHUMËDIMENSIONALE**

Marin Barleti është konsideruar përherë si një zë më vete e përfaqësues i një roli të veçantë në disa pikëpamje, ndër të cilat për zgjedhim të ndërmendim pikërisht vendin që historikisht i është rezervuar në trajtesa, botime dhe punime që kanë pasur objekt të vëmendjes historinë e shkrimit dhe historinë e letërsisë sonë. Nuk ka qenë me më pak interes trajtimi i jetëshkrimit dhe hulumtimi mbi rrugëtimin biografik e profesional të tij, hulumtim që është kushtëzuar nga disa faktorë, ndër të cilët do të veçonim si mundësinë për të gjurmuar në arkiva specifike mbi figurën e tij interesante, por dhe periudhat në të cilat është rimarrë dhe trajtuar historia e letërsisë sonë të shkruar. Tradicionalisht do të gjinden dhe konsultohen botime në gjuhën tonë në të cilat me të drejtë këtij prelati i janë kushtuar zëra më vete, duke e dalluar dhe nga shkrimtarë e personalitete bashkëkohëse apo paraardhëse, me të cilat e përbashkonin një sërë rrethanash që kishin të bënin me zhvillime shumë specifike për kohën në të cilën jetonin popullsitë tona në veri të Shqipërisë.

Shqipërimi i secilës prej veprave të Barletit ka zbuluar aspekte të reja studimore shkrimtarie dhe të elementeve që mbeten individuale edhe duke qenë të sjella në një gjuhë tjetër tekstet e përpiluara prej tij. Nuk mund të mos vihet re dhe pozicionimi i shqipëruetit që duke njohur mirë brendinë e veprës së shkruar në gjuhën latine dhe detaje përmbajtësore, që i reflekton dhe në zgjedhjet që pasqyrojnë në tekstin e përkthyer, përfton natyrshëm disa hollësi që i qëndrojnë më së miri natyrës dhe gjithë subjektit që shtjellohet falë një filli tematik, që qëndron mes mesjetares, rrëfimit epik dhe gjithashtu dramatik, por pa humbur ndjesinë e kombëtares, një element ky që synon të përvijohet nga paragrafi në paragraf, nga kapitulli në kapitull. Impenjimi me veprat e Barletit nënkupton natyrshëm dhe një lloj përfshirjeje të filologut, historianit dhe mbi të gjitha shqipëruetit që ndërmerr sprovën aspak të lehtë të përafrimit me një realitet të ndryshëm gjuhësor një korpus të tërë tekstor, që nuk përbëhet vetëm prej notash dedikatore, kushtesash dhe përshkrimesh të

natyrës epike e dramatike, por mbi të gjitha prej rrëfimesh që kanë të bëjnë me episode themelore në rastin e biografisë së Kastriotit, por dhe ngjarjesh gjithashtu themelore, nëse i referohemi qëndresës historike të banorëve të kështjellit të Shkodrës në gjysmën e dytë të Katërqindës. Rrethimi i qytet-kështjellave dhe rezistenca e vendasve ndaj presionit të pushtuesit që ndikon me fuqinë e ekspozuar në gjithfarë mënyrash dhe faktorin numerik mbetet një argument i trajtuar nën një optikë që bashkon autorë dhe vepra. Në rastin e autorit tonë, është e qartë se ai synon të nënvizojë që të rrethuarit janë bartës të një identiteti të formuar e të konsoliduar, që besojnë në një kult të rrënjosur prej kohësh në psiken dhe jetën e tyre, që e përjetojnë si rrezik të tjetërsimit të individualitetit etnik rrethimin prej të huajve, të mbiquajtur jo rrallë dhe *barbarë*. Një fakt i tillë në veprën *De Obsidione Scodrensi* konkretizohet dhe nëpërmjet fjalimesh dhe ligjëratash të shtrira si tekste dhe që mbeten dhe një mundësi për të shtjelluar dhe fakte historike, që i shërbejnë boshtit tematik të veprës së Barletit.

Përballja e palëve nënkupton para së gjithash një qasje kulturash e dokesh që në rastin konkret bën të dalë në pah një diversitet i theksuar në shumë pikëpamje. Njëra palë synon të jetë ndikuese me ritet e zbatuara që në fillim të mbërritjes në rrethinat e kështjellit, të sugjestionojë me larminë dhe specifikën e forcave të rekrutuara, me mjeshtërinë ushtarake që beson se e zotëron natyrshëm dhe si një dhunti pothuaj të vetëlindur; pala tjetër mbrohet me mënyra të tjera, duket gjithashtu sikur faktori numerik i shpërpjesëtuar ndaj forcave armike nuk do të jetë në favor të saj.¹ Mjeshtëria e autorit do të provohet ndër të tjera veçanërisht nga përsoshkrime të të dyja kampeve, nga të cilët sigurisht të rrethuarit do të marrin më tepër vëmendje dhe nga ana e lexuesit. Do të jetë kjo vëmendje që do të bëjë të mundur që në lidhje me të njëjtin komponent në pikëpamje të subjektit të vërehet me sy kritik si paraqitet e njëjta situatë në veprën mbi jetën dhe bëmat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e të njëjtit autor, gjithashtu dhe në autorë të letërsisë sonë që rimorën në periudha të mëvona një fill të ngjashëm tematik për ta kontekstualizuar në bashkëkohësi të njëjtën pjesë

¹ M. Barleti, *Rrethimi i Shkodrës, përktheu Henrik Lacaj, përgatiti për botim D. Hosaflook*, Botime Onufri, Tiranë, 2012, f. 141: Ndërkaq, në të katër anët e qytetit dëgjoheshin zëra, që bërtitnin duke lëshuar kushtrimin: “O të krishterë e besnikë, ju burra, gra, djem e vajza; o ju të plagosur e të shituar, edhe ju o të sëmurë, që dergjeni në të shtruara, vraponi te porta e madhe; shpejtoni, shpejtoni në ndihmë të shokëve që u këputën fare e po mbarojnë: shpejt, se armiku po shtohet gjithnjë e më tepër, na mbyti me sulme; thuajse e shtiu në dorë qytetin, iu fut përbrenda”.

historie e duke i shërbyer gjithashtu një nënteksti të qartë në pikëpamje të nënvizimit të rëndësisë së identitetit kombëtar.

Ndikimi i shqipëruesit nga teksti latin vërehet qartë në veprën mbi historinë e jetës dhe bëmave të Skënderbeut. Do të shihet qartë se janë dalluar dhe në pikëpamje ortografike emërtesat e natyrës etnike, njësitë gjeografike që lidhen me ngjarje të rëndësishme të të gjithë subjektit skënderbeian. Përdorimi i shkronjës së parë të madhe merr një konotacion të veçantë në këto tekste, duke qenë se përmes saj shënohen e nënkuptohen personazhe të caktuara, dallohen vende dhe koncepte me rëndësi të veçantë për vetë përmbajtjen e veprës, klasifikohen palët dhe popujt në përgjithësi. Nuk është aspak rastësi përdorimi në njëjës apo përkatësisht në shumës i emërtesave të caktuara, gjithnjë duke e përforcuar këtë fakt dhe qasja me tekstin gjegjë në gjuhën latine. Kjo qasje e shpënë më tej dhe duke krahasuar koherencën e autorit nga njëra vepër në tjetrën pikërisht në lidhje me përdorime të caktuara, ndihmon të vëmë në dukje dhe veçori të tjera në pikëpamje të të shkruarit të veprave të Barletit.

Veçanti në pikëpamje interpretimi do të paraqesin në këndvështrimin tonë si variantet që janë përpiluar në gjuhën latine, ashtu dhe variantet gjegjëse në gjuhën shqipe, e në lidhje me këtë të fundit vihen re dallime në pikëpamje dhe të paraqitjes ortografike të mjaft fjalëve, paraqitje që kushtëzohet nga vetë tematika e veprës dhe ndikimi nga varianti në gjuhën latine, që kishte parasysh shqipëruesi në proces të punës së tij me tekstin.

Këtu do të shtonim që të tilla variante e bëjnë më interesante punën e filologut me vetë tekstet e përpiluara nga autori në fjalë, por ndërlikojnë gjithsesi dhe vetë qasjen e shqipëruesit, që në këto raste patjetër do të duhet të vërë në përdorim dhe në shërbim të punës së vet kompetenca të mirëfillta të dijes së filologjisë. Çështja e realizimit të varianteve të ndryshme të së njëjtës vepër mbetet një tjetër argument që shoqëron në mënyrë të pandashme konsiderimin e shkrimtarisë së Marin Barletit dhe të individualitetit të tij. Përforcohet ky mendim yni dhe nga të rejat e ditëve të fundit nga të cilat mësuam se ekzistojnë të tjera kësomblla të së njëjtës vepër, me shumë mundësi të realizuara ndonjë vit para botimit që njëhej tradicionalisht në studimet mbi veprën dhe autorin, nga përmbajtja e të cilave mund të gjurmohen tipare të tjera, veçori të tjera të ndërtimit të

tekstit dhe të tjera dispozita të vetë autorit ndaj përdorimeve të caktuara që dihet se përdoren në variantin e njohur deri më sot të kësaj vepre.²

Sa i takon vetë veprës së Marin Barletit, duhet thënë që jo rrallë paragrafe të caktuara të saj janë bërë objekt kritikash apo dhe janë konsideruar të ngatërruara për arsye të ndërfutjes së elementeve që kujtojnë shkrimtarinë apo pasazhe të caktuara nga veprat e autorëve klasikë, stili i të cilëve dhe nuk mund të përshtatet natyrshëm me vetë trajtesat e Barletit dhe me episode që përshkruhen në to, dhe pse ky i fundit ka pasur sigurisht prirjen për të përforcuar kësisoj natyrën rrëfimore të krijimtarisë së tij.³

Vepra ndër të tjera karakterizohet nga një prani më se e justifikuar e elementeve të një leksiku ushtarak të përpunuar, aspak rastësor dhe që përforcon frymën tematike që ka të bëjë me një strateg, hero të luftërave të vështira, personalitet që ka rol dhe autoritet të njerëzimit që e rrethojnë që në krye të herës. Të tilla vepra me të drejtë konsiderohen relike në ditët tona për arsye të një arsenali të pasur leksikor që përmbajnë, për arsye dhe të mundësisë që japin për të rindërtuar në këndvështrim të disa nënsistemeve një panoramë me pikënisje diakronike për mjaft përdorime dhe zgjedhje të ndërmarra nga vetë autori.

Leximi i veprës së Marin Barletit në gjuhën latine ofron një çelës për ta kuptuar më qartë krejt epopenë e Kastriotit dhe në këto raste dihet fare mirë që gjuha dhe mjetet që ajo disponon mbeten artificet më efikase për ta bërë të paharruar (mbresëlënës) si krejt subjektin në fjalë, ashtu dhe vetë veprën si një ndërtesë të përbërë nga elemente gjuhësore dhe letrare, dramatike, legjendare, por dhe historike.

Autori i historisë së jetës dhe bëmave të Kastriotit ka përdorur në këtë vepër mjaft shprehje dhe sintagma që i përkasin pikërisht latinishtes klasike dhe evokojnë në të vërtetë një mentalitet të largët në krahasim me epokën në fjalë, në të cilën vetë shkrimtari ynë paraqitet nën veshjen meshtarake, të cilën e ka kurorëzuar pas një formimi të konsiderueshëm

² Botimi i parë i *Rrethimit të Shkodrës (De obsidione Scodrensi)* në gjuhën latine në Venedik koïncidon pothuajse me 100-vjetorin e lindjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

³ Sa i takon faktit që shpesh ngulmohet nga kritika e huaj në lidhje me shprehje e përdorime të pranishme dhe në autorë të njohur të letërsisë latine, duhet verifikuar dhe mos bëhet fjalë për një prirje të kohës, duke qenë primare pikërisht atëherë dhe mbrujtja dhe formimi me elemente institucionale të gjuhës e të kulturës latine, në të cilat bënin pjesë pa dyshim dhe autorë të cilët njihen si përpilues veprash që evokojnë ngjarje të rëndësishme në historinë e Res Publica-s romane.

dhe serioz për kohën. Ndërkaq që në hyrjen e veprës do të gjejmë evokime (pjesë e ndërtimit të frazës gjithsesi) ndaj perëndish të veçanta të një bote klasike, do të gjejmë përdorime në shumës të fjalëve që lidhen drejtpërdrejt me një gjendje reliktoze të kësaj gjuhe e që origjinën e kanë në një periudhë parakristiane.

Vështrimi i krahasuar në pikëpamje të hulumtimit tekstor bën të rezervohen detaje e veçanti në lidhje me të dyja variantet, duke u konsideruar secili prej tyre si paraqitës i një sprove serioze në një lamije të rëndësishme që ka të bëjë me shkrimtarinë në radhë të parë, por dhe me përkthimtarinë si një fushë që shtjellon në këtë rast dhe qëndrime të shqipëruesit që ka rol autorësie në disa pikëpamje.

Në një vepër si e ajo e Marin Barletit mbi jetën dhe bëmat e Skënderbeut puna e shqipëruesit diferencohet në disa drejtime: ligjëratat që vihen në gojën e heroit të veprës kërkojnë përshtatjen me një stil të veçantë ligjërimor dhe me një sërë shprehjesh që i gjegjen vetë intonimit të krejt tekstit, të mbartur me evokime e përdorime tipike për këtë mënyrë të drejtuar ndaj një publiku si ai i ushtarëve që kalojnë kohë të gjata nëpër beteja e luftime; emërtesat që lidhen me personazhe që personifikojnë pushtetin, armikun, kundërshtarin, fuqinë politike të kohës do t'i gjegjen dhe në pikëpamje ortografike variantit latin (siç dhe ka vepruar disa herë shqipëruesi ynë)⁴; vëmë në dukje gjithashtu që emërtime vendesh dhe zonash dhe që në tekstin latin të veprës mbi Kastriotin janë dhënë në numrin shumës në gjuhën shqipe duhen dhënë në përputhje me modelin ekzistues të saj. Në të vërtetë, qëndrimi i shqipëruesit nuk ka munguar dhe në të tilla raste, që janë specifike dhe jo thjesht nga pikëpamja e morfologjisë së fjalëve të caktuara.

Botimet në gjuhën latine të veprës së Marin Barletit introduktohen nga një indeks i pasur, që karakterizohet nga një tematikë e theksuar informative, që bën të mundur dhe një përafrim më të lehtësuar me përmbajtjen dhe në veçanti me episode që përshkruhen me hollësi në këtë vepër. Evidentimi i hollësishëm i elementeve që përmbahen më tej në librat që përbëjnë veprën bëhet një introduktim i natyrshëm i shtjellimeve që shkojnë më së miri me natyrën dhe destinacionin e veprës së Barletit, që përmban qartë motivimin për ta orientuar lexuesin drejt betejash, luftërash, ndeshjesh trup me trup dhe një sërë episodesh që priten të jenë pjesë e një veprë të një karakteri të tillë. Njëkohësisht dhe një procedurë e tillë që në

⁴ Shih ndër të tjera dhe përdorime si Otomani, Tirani, Plaku (M. Barleti, *Historia e Skënderbeut, shqipëroi S. Prifti, botim i cituar*, f. 155).

fillimet e veprës bën të mundur të rikrahasojmë dhe realizimin e Barletit me të tjera modele librare të kohës, në të cilat gjinden të pranishme elemente të ngjashme tekstore dhe në pikëpamje të introduktimit të lëndës që do të shtjellohet. Gjejmë rastin të vëmë në dukje që dhe pasqyra e përmbajtjes në gjuhën shqipe e që introdukton botimin e fundit të *Rrethimit të Shkodrës* (2012) e kryen në njëfarë mënyre një rol të tillë, në veçanti në rast përdorimesh që pasojnë njëri-tjetrit dhe përforcojnë frymën e kohës dhe të ngjarjes në fjalë.⁵

Pavarësisht faktit që shekujt në vijim kanë shënuar një rritje progresive në disa pikëpamje të kontributeve në lidhje me jetën dhe bëmat e Gjergj Kastriotit, si dhe reflektimin përkatës në mënyrë specifike në drejtim të gjurmimeve historiografike, vepra e Marin Barletit vijon të jetë një burim i vyer në pikëpamje të reflektimit të një përmase të konsiderueshme besueshmërie dhe referencialiteti të konkretizuar në mjaft botime që pikënisjen e tyre e kanë dhe në një motivim konkret: ta rishkruajnë historinë e Skënderbeut duke pasuruar në pikëpamje dokumentare, por dhe gjykimesh një rrugëtim serioz që shënoi vetë historinë e kombit tonë dhe të viseve të tjera të lidhura me të. Në njëfarë mënyre, fakte të tilla përbëjnë dhe një lloj revizionimi kritik të konsiderimit të kësaj vepre, sigurisht duke i njohur dhe në pikëpamje objektive motivimin, vlerat dhe natyrën gjinore të diktuar dhe nga vetë zhvillimet e kohës.⁶

Disponimi i të dhënave biografike mbi këtë autor pasuron ndjeshëm një kuadër që e ka të nevojshëm prej kohësh plotësimin e të dhënave mbi autorët që shënuan shekuj të rëndësishëm për zhvillimet kulturore në vendin tonë dhe në areale më të gjera. Të tilla gjurmime përherë të domosdoshme sjellin më afër autorët e letërsisë sonë, të cilët rikontretizohen nëpërmjet indicesh që në të vërtetë hedhin dritë mbi një kontekst më të gjerë zhvillimesh historike që në mënyrë të pashmangshme përfshijnë dhe vise specifike të Shqipërisë së atëhershme. Kritika mbi Barletin dhe pozicionimin që ai shfaq në secilën prej veprave të tij meriton një vëmendje të veçantë nga këndvështrime të ndryshme. Ajo nuk ka

⁵ M. Barleti, *Rrethimi i Shkodrës, përktheu Henrik Lacaj, përgatiti për botim D. Hosaflook*, Botime Onufri, Tiranë, 2012, f. XI-XIV.

⁶ Sa u përket disa qëndrimeve kritike në lidhje me episode të caktuara nga historia e Skënderbeut e shkruar nga Marin Barleti mund të citojmë disa pasazhe nga vepra me të njëjtin argument qendror e Fan Nolit (më konkretisht botimi i vitit 1950, Boston), në të cilat gjejmë dhe përshtypje dhe interpretime të autorit mbi elemente konkrete që gjurmohen në librat e veprës së Barletit.

munguar veçanërisht në raste kur punime të caktuara janë përpiluar duke e pasur veprën e këtij të fundit objektiv qendror dhe argument trajtimi të gjerë e të motivuar. Do të citonim në këtë këndvështrim trajtesat e Francisc Pall që e konsideron dhe trajton gjerësisht veprën dhe kontributin e Barletit, duke marrë në analizë dhe aspekte të personalitetit të tij si humanist dhe historian.⁷ Do të ndërmendnim dhe shënimet sqaruese të studiuesit Aleks Buda pikërisht në lidhje me trajtesat me të cilat Barleti introdukton *Rrethimin e Shkodrës*, gjithashtu dhe kontribute të arkeologëve tanë të antikitetit e të mesjetës, që e kanë ndier të nevojshme të saktësojnë ubikime dhe koordinata gjeografike apo pika të relievit të përshkruar në veprat e Marin Barletit.

Marin Barleti mbetet një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm të Pesëqindës, i konsideruar i tillë në trajtesat përkatëse që pasqyrohen në manuale dhe botime që kanë objekt të tyre pikërisht periudhën në fjalë dhe autorë të veçantë, ndër të cilët dhe disa që kanë përpiluar dhe realizuar veprat e tyre në një gjuhë librore dhe kulturore *par excellence*, siç ishte latinishtja në atë kohë. Për fatin tonë të mirë, elemente në dukje teknike që kanë të bëjnë me realizimin tipografik të veprave të tij, frontespici me figuracionin e pasur që pa dyshim mbart nëntekste të qarta që i referohen brendisë dhe vetë motivimit për ta shkruar një vepër të tillë, janë bërë objekt trajtimesh serioze dhe të thelluara, duke shpënë më tej dhe kërkimet mbi vetë periudhën në fjalë, mbi qerthujt kulturorë që mbështetën të tilla iniciativa botimi dhe që kishin për zemër si konkludimin e suksesshëm në të tilla realizime të natyrës tipografike, aq dhe përkrahjen e biografëve dhe shkrimtarëve që me përgatitjen e tyre në të vërtetë i shërbyen dhe historisë së vendit nga mendohet se kishin ardhur. Konteksti që ushquu dhe i shërbeu si një suport i qartë dhe i sigurt Marin Barletit që pa dyshim i përbërë nga njerëz të kulturës dhe që mbështetnin dijen dhe humanitetin, ndër të tjera dhe që nga ana e tyre kishin arritur një pjekuri të konsiderueshme në pikëpamje të afirmimit të tyre në rrethet kulturore më në zë të kohës në të cilën jetonin. Motivimi në pikëpamje të realizimit të një vepre mirëfilli tematike si ajo mbi jetën dhe bëmat e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut duhet gjetur pikërisht në rrethanat në të cilat të tillë mecenatë zhvillonin dhe interesat dhe veprimtarinë e tyre kulturore. Të tilla rrethana, të trajtuara dhe së fundmi nga studiuesit e vetë periudhës për të cilën bëjmë

⁷ F. Pall, *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV (Documenti inediti con introduzione e note storico-critiche)*, Società napoletana di storia patria, Napoli, 1966.

fjalë, bënë të mundur që dhe mbi një figurë kaq komplekse si ajo e prijësit të viseve arbërore të dilte nga shtypi një vepër e përmasave të konsiderueshme, gjithashtu të kishte dhe një jehonë po aq të konsiderueshme përmes ribotimeve dhe rimarrjes në variantet përkatëse në disa gjuhë të Evropës. Në pikëpamje të një leximi kritik të veprave të Barletit e për të cilin ka argumente dhe lëndë për të cilën mund të flitet e trajtohet gjerësisht, duhet thënë që një fakt i tillë nuk zvetënon rëndësinë e disponimit të realizimeve të tilla nga tradita jonë e historisë së shkrimit, duke qenë në themel të motivimit të pikënisjes së tyre dhe një lloj panorame e natyrës historike që pa dyshim bëri të mundur të grishte interesin dhe kureshtjen e lexuesit të kohës, në veçanti të atij evropian. Në pikëpamje zbatueshmërie, këto vepra mbeten më me interes për t'u përfshirë në korpuse antologjike mbi letërsinë e shkruar, në tekste shkollore parauniversitare, e jo vetëm në libra të letërsisë. Biografët e Gjergj Kastriotit mbeten shkrimtarë dhe narratorë, kronikanë, por dhe historianë në kornizën e kohës në të cilën jetuan. Në të njëjtën kohë, ata ofrojnë pa dyshim disa pista kërkimi në drejtim të sqarimit të autenticitetit të të shkruarit, referimit të saktë ndaj ngjarjesh e datash, episodesh dhe marrëdhëniesh ndërshtetërore. Narrativa dokumentare dhe historike, rrëfimi që përfshin dhe integrimin në pikëpamje roli prej protagonistit të personazheve të veçanta, por që kanë rol bazilar në jetën dhe rrugëtimin biografik të heroit qendror të veprës, mbeten karakteristika konstitutive të ndërtimit dhe shtjellimit të subjektit të këtyre veprave.

Rinovimi i vëmendjes dhe i interesit ndaj veprave të autorit tonë vjen dhe nëpërmes risjelljes në objekt të kureshtjes së brezave pikërisht me anë të ribotimeve që në të vërtetë mund të jenë një mundësi e artë që të paraqitet secila prej tyre nën kornizën e një aparati kritik të rindërtuar e të studiuar mirë, qoftë dhe duke marrë parasysh botime të mëparshme, pse jo dhe ato që përbëjnë përkthime në gjuhë të tjera të huaja përveç latinishtes, por dhe duke rivlerësuar kontributet e shqipëruessve të tyre, gjithsecili reflektues në pikëpamje metodologjike dhe formimi i një kontributi pa dyshim të çmuar dhe me vlera që jetojnë me të njëjtën gjallëri dhe në ditët tona. Të tilla kontribute mbeten të papërsëritshme për shumë arsye dhe meritojnë të rivlerësohen nëpërmjet rimarrjes së tyre në botime kritike siç është ai i viteve të fundit mbi *Rrethimin e Shkodrës* dhe që rimerr qëndrime dhe parathënie të njohura më parë, merr parasysh dhe variante botimesh të mëparshme të të njëjtit shqipërim, duke pasuruar e mbështetur traditën ekzistuese të njohur prej nesh.